



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Prill 2021

Nr: 311

V E N D I M

**PËR KONSTATIMIN DHE SHQYRTIMIN E KUNDËRVAJTJES ADMINISTRATIVE PËR
SHKELJE TË KODIT ZGJEDHOR NGA ANËTARËT DHE SEKRETARI
I KZAZ-SË NR. 69, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 2, 119, 122, pika 1, dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”

V Ë R E J

Në datën 25.04.2021, në 12 zonat zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Për 92 KZAZ procesi i numërimit ka filluar rreth orës 22:00 të datës 25.04.2021. Neni 119, pika 5, përcakton se *procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuarra të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit.*

Referuar nenit 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në të cilin përcaktohet se Tabela përmbledhëse e rezultait të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZA-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.

KZAZ nr. 69, Qarku Korçë, deri në orën 22:00 të datës 26 Prill 2021, ka numëruar fletë votimi për 51 QV nga 106 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 48.11%, pra KZAZ nuk ka arritur të përmbushë detyrimin për numërimin e fletëve të votimit, dhe është në kufirin nën 50% të QV-ve për këtë zonë të administrimit zgjedhor.

Për sa më sipër, KZAZ-ja nr. 69, ka shkelur dispozitën e sipërcituar dhe dënohet me sanksion administrativ, gjobë sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në neneve 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 2, 119, 122, pika 1, dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”

V E N D O S :

1. Sanksion administrativ, gjobë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtarë dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 69, qarku Korçë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



1	Polikron	Baftjar	Balliu	Kryetar	PD
2	Musa	Asllan	Abrashi	Zv.Kryetar	PS
3	Manjola	Nexhmi	Mulla	Anëtare	PS
4	Endri	Rushan	Çela	Anëtar	PD
5	Oligert	Viktor	Muçllari	Anëtar	PD
6	Denis	Hazbi	Mekolli	Anëtar	LSI
7	Naze (Sava)	Kamber	Mokrëri Ropçe	Anëtare	PSD
8	Zhuljen	Perend	Manellari	Sekretar	PS

